



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 684/ 9 prot

Datë 08.04.2026

V E N D I M
Nr. 480/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.04.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “*L.T.E Construction*” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Proçedurë e hapur*” me Nr. REF-71241-12-05-2025, me objekt “*Sistemim dhe Asfaltim i Rugës së Fshatit Rashtan, Faza e Dytë, Bashkia Prrenjas*” me fond limit: 42,135,943.04 (*dyzet e dy milion e njëqind e tridhjetë e pesë mijë e nëntëqind e dyzet e tre pikë zero katër*) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 29.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Prrenjas.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Prrenjas.
Adresë: Rruga “Skënderbej”, Godina 15, Prrenjas.

Ankimues: Operatori ekonomik “*L.T.E Construction*” SHPK me NIPT L78006801F, me adresë: Rruga “3 Dëshmorët”, Kompleksi Grand, Ap Nr. F-2-08, Kati 1, Tiranë.

Subjekt i Interesuar: Operatori Ekonomik “*Rej*” SHPK, me NUIS J93711608Q, me adresë rruga “Dritan Hoxha”, Kulla Jeshile ngjitur me shkollën “Ahmet Gashi”, Nr. 8/374/ND+3-6, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:**I***Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 09.12.2025 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-71241-12-05-2025, me objekt “Sistemim dhe Asfaltim i Rugës së Fshatit Rashtan, Faza e Dytë, Bashkia Prrenjas” me fond limit: 42,135,943.04 (dyzet e dy milion e njëqind e tridhjetë e pesë mijë e nëntëqind e dyzet e tre pikë zero katër) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 29.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Prrenjas.

II.2. Në datën 29.12.2025 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se në datën 16.01.2026 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1- “Nika” SHPK	27.389.670	lekë kualifikuar
2- “L.T.E Construction” SHPK	28.033.664.40	lekë kualifikuar
3- BOE “Asi Invest” SHPK & “Company Riviera 2008” SHPK	28.189.581	lekë kualifikuar
4- “Rej” SHPK	28.708.974	lekë kualifikuar
5- “Vëllezërit Hysa” SHPK	29.212.061	lekë kualifikuar
6- “Ndërtimi” SHPK	29.321.856.9	lekë kualifikuar
7- “K.M.K” SHPK	29.916.999	lekë kualifikuar
8- “Drini 1” SHPK	30.109.380	lekë kualifikuar
9- “Caushi M” SHPK	30.718.905	lekë kualifikuar
10- “Bonus” SHPK	30.845.451	lekë kualifikuar
11- “Rruga Ura Asfaltim Nr. 2 Elbasan” SHPK	31.041.655.20	lekë kualifikuar
12- BOE “Ouen” SHPK & “Shpresa AI” SHPK	31.149.552	lekë kualifikuar
13- BOE “Murati” SHPK & “Klejgi Duri” SHPK	31.590.407	lekë kualifikuar
14- “Shëndëlli” SHPK	32.036.970	lekë kualifikuar
15- “Ndregjoni” SHPK	32.166.393	lekë kualifikuar
16- “Xhast” SHPK	32.201.904	lekë kualifikuar
17- “Bami Holding” SHPK	32.916.502.50	lekë kualifikuar
18- “Varaku E” SHPK	39.856.530	lekë kualifikuar
19- “K. Turja” SHPK	39.874.475	lekë kualifikuar

II.4. Referuar sistemit të prokurimeve elektronike si dhe informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se më datë 16.01.2026 operatorit ekonomik i kualifikuar i pari “Nika” SHPK i është kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor dorëzimi i dokumentacionit sipas parashikimeve ligjore.

II.5. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se në datën 22.01.2026 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1- “Nika” SHPK	27.389.670	lekë skualifikuar
----------------	------------	-------------------

2- "L.T.E Construction" SHPK	28.033.664.40	lekë	kualifikuar
3- BOE "Asi Invest" SHPK & "Company Riviera 2008" SHPK	28.189.581	lekë	kualifikuar
4- "Rej" SHPK	28.708.974	lekë	kualifikuar
5- "Vëllezërit Hysa" SHPK	29.212.061	lekë	kualifikuar
6- "Ndërtimi" SHPK	29.321.856.9	lekë	kualifikuar
7- "K.M.K" SHPK	29.916.999	lekë	kualifikuar
8- "Drini 1" SHPK	30.109.380	lekë	kualifikuar
9- "Caushi M" SHPK	30.718.905	lekë	kualifikuar
10- "Bonus" SHPK	30.845.451	lekë	kualifikuar
11- "Rruga Ura Asfaltim Nr. 2 Elbasan" SHPK	31.041.655.20	lekë	kualifikuar
12- BOE "Ouen" SHPK & "Shpresa AI" SHPK	31.149.552	lekë	kualifikuar
13- BOE "Murati" SHPK & "Klejgi Duri" SHPK	31.590.407	lekë	kualifikuar
14- "Shëndëlli" SHPK	32.036.970	lekë	kualifikuar
15- "Ndregjoni" SHPK	32.166.393	lekë	kualifikuar
16- "Xhast" SHPK	32.201.904	lekë	kualifikuar
17- "Bami Holding" SHPK	32.916.502.50	lekë	kualifikuar
18- "Varaku E" SHPK	39.856.530	lekë	kualifikuar
19- "K. Turja" SHPK	39.874.475	lekë	kualifikuar

II.6. Në datën 22.01.2026 operatori ekonomik "Nika" SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

Nga verifikimi i dokumentacionit fizik të paraqitur nga operatori ekonomik NIKA shpk rezultuan këto mangesi: 1.Për mjetin Kamioncinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton me targë AB 618 HZ të deklaruar në pronësi nga OE NIKA shpk mungon certifikata për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet (e vlefshme), në kundërshtim me pikën 8/a të kapaciteteve teknike. Në nenin 45 të Ligjit Nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për Transportet Rrugore", i ndryshuar, parashikohet se: Transporti i mallrave për nevojat e veta brenda vendit është i ndaluar të kryhet pa certifikatë. 2. Për mjetin Autobot uji me targë AA485NV të deklaruar me qira mungon certifikata për transport mallrash brenda vendit për të tretë dhe me qira (e vlefshme), në kundërshtim me pikën 8/b të kapaciteteve teknike 3.Për mjetin Autobitumatriçe me targë AB811GM të deklaruar me qira mungon certifikata për transport mallrash brenda vendit për të tretë dhe me qira (e vlefshme), në kundërshtim me pikën 8/b të kapaciteteve teknike si dhe Leja e Transportit të Mallrave të Rrezikshme (e vlefshme), leshuar nga organet kompetente në emer të shoqërisë apo subjektit pronar të mjetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.-Në nenin 41 të Ligjit Nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për Transportet Rrugore", i ndryshuar, parashikohet se : Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.-Bazuar në nenet 5, 8 dhe 9 të Ligjit nr. 118/2012, datë 13.12.2012 "Për transportin e mallrave të rrezikshme", si dhe në zbatim të Marrëveshjes ADR(Marrëveshja për Transportin Ndërkombëtar të Mallrave të Rrezikshme në Rrugë), mjetet që transportojnë mallra të rrezikshme në rrugë janë të detyruara të pajisen me certifikatë

miratimi ADR për mjetin. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se oferta nuk përmban të gjithë dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e tenderit, referuar listës së kërkesave të tenderit, në mbështetje të nenit 82 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “ Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar. Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me Nenin 77, 87,92 të Ligjit 162/2020, “Për Prokurimin publik”i ndryshuar si dhe Dokumentave Standarde të Tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e operatorit ekonomik NIKA shpk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar si ofertë të pavlefshme.

II.7. Referuar sistemit të prokurimeve elektronike si dhe informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se më datë 22.01.2026 operatorit ekonomik i kualifikuar i pari “L.T.E Construction” SHPK i është kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor dorëzimi i dokumentacionit sipas parashikimeve ligjore.

II.8. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se në datën 22.01.2026 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1- “Nika” SHPK	27.389.670	lekë skualifikuar
2- “L.T.E Construction” SHPK	28.033.664.40	lekë skualifikuar
3- BOE “Asi Invest” SHPK & “Company Riviera 2008” SHPK	28.189.581	lekë kualifikuar
4- “Rej” SHPK	28.708.974	lekë kualifikuar
5- “Vëllezërit Hysa” SHPK	29.212.061	lekë kualifikuar
6- “Ndërtimi” SHPK	29.321.856.9	lekë kualifikuar
7- “K.M.K” SHPK	29.916.999	lekë kualifikuar
8- “Drini 1” SHPK	30.109.380	lekë kualifikuar
9- “Caushi M” SHPK	30.718.905	lekë kualifikuar
10- “Bonus” SHPK	30.845.451	lekë kualifikuar
11- “Rruga Ura Asfaltim Nr. 2 Elbasan” SHPK	31.041.655.20	lekë kualifikuar
12- BOE “Ouen” SHPK & “Shpresa AI” SHPK	31.149.552	lekë kualifikuar
13- BOE “Murati” SHPK & “Klejgi Duri” SHPK	31.590.407	lekë kualifikuar
14- “Shëndëlli” SHPK	32.036.970	lekë kualifikuar
15- “Ndregjoni” SHPK	32.166.393	lekë kualifikuar
16- “Xhast” SHPK	32.201.904	lekë kualifikuar
17- “Bami Holding” SHPK	32.916.502.50	lekë kualifikuar
18- “Varaku E” SHPK	39.856.530	lekë kualifikuar
19- “K. Turja” SHPK	39.874.475	lekë kualifikuar

II.9. Në datën 22.01.2026 operatori ekonomik “L.T.E Construction” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

Pas mbylljes së fazës së vlerësimit të ofertave komisioni vendosi ti dërgojë në datë 22.01.2026 njoftim për paraqitje dokumentacioni fizik operatorit të renditur i pari L.T.E Construction shpk.

Dokumentacioni u paraqit nga OE L.T.E Construction shpk në datë 26.01.2026.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur fizikisht nga OE “L.T.E Construction” shpk me nipt L78006801F me adresë: Rruga 3 Deshmoret, Kompleksi Grand, Ap F-2-08 kati 1, Kashar, Tirane 1001, me administrator Artur Caushaj, u konstatua se nuk ka arritur të paraqesë dokumentacionin e plote dhe të sakte për të dëshmuar plotësimin e kriterëve të vecanta për kualifikim sipas dokumentave standarte të tenderit më konkretisht:

1. Nuk ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e plotë sipas pikës 5 dhe 5.1 Kriteret e Vecanta të Kualifikimit (Kapaciteti teknik) të DST.

5. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik per kryerjen e punimeve, te vertetuar me kontratë punë te vlefshme, një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/ certifikatë/diplomë) nga organe kompetente si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë për muajin e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, si më poshtë:

- 1(një) manovratore/automakinist*
- 2 (dy) manovratore/ekskavatorist*
- 2 (dy) punonjës shofer*
- 4 (katër) Specialist betonimi*
- 10(dhjetë) punonjës të thjeshtë ndërtimi.*

5.1 Për punonjesit manovrator/shofer/ekskavatorist, ofertuesi duhet të paraqesë: - kontratën individuale të punës te vlefshme; -leje drejtimi sipas kategorise perkatese, certifikate e aftesise profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR.

Në rastin kur punonjësit Ekskavatoriste/Automakinist /shofer janë të kontraktuar me kontratë pune, respektivisht për mjetet e marra me qira, nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë). Nga verifikimi i dokumentacionit fizik të paraqitur nga operatori ekonomik “L.T.E Construction” shpk rezultuan këto mangesi: Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit janë deklaruar si Automakinistë punonjësit Endrit Sulozeqi dhe Leonard Rozi. Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se për këta punonjës mungon leja e drejtimit të mjetit, në kundërshtim me nenin 115 të Ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i cili përcakton se drejtimi i mjeteve motorike mbi 3.500 kg kërkon leje drejtimi të vlefshme. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se oferta nuk përmban të gjithë dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e tenderit, referuar listës së kërkesave të tenderit, në mbështetje të nenit 82 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar. Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me Nenin 77, 87,92 të Ligjit 162/2020, “Për Prokurimin publik”i ndryshuar si dhe Dokumentave Standarde të Tenderit të miratuara,

u konstatua se oferta e operatorit ekonomik “L.T.E Construction” shpk nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar si ofertë të pavlefshme.

II.10. Referuar sistemit të prokurimeve elektronike si dhe informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se më datë 12.02.2026 operatori ekonomik i kualifikuar i pari BOE “Asi Invest” SHPK & “Company Riviera 2008” SHPK i është kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor dorëzimi i dokumentacionit sipas parashikimeve ligjore.

II.11. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se në datën 12.02.2026 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1- “Nika” SHPK	27.389.670	lekë skualifikuar
2- “L.T.E Construction” SHPK	28.033.664.40	lekë skualifikuar
3- BOE “Asi Invest” SHPK & “Company Riviera 2008” SHPK	28.189.581	lekë skualifikuar
4- “Rej” SHPK	28.708.974	lekë kualifikuar
5- “Vëllezërit Hysa” SHPK	29.212.061	lekë kualifikuar
6- “Ndërtimi” SHPK	29.321.856.9	lekë kualifikuar
7- “K.M.K” SHPK	29.916.999	lekë kualifikuar
8- “Drini 1” SHPK	30.109.380	lekë kualifikuar
9- “Caushi M” SHPK	30.718.905	lekë kualifikuar
10- “Bonus” SHPK	30.845.451	lekë kualifikuar
11- “Rruga Ura Asfaltim Nr. 2 Elbasan” SHPK	31.041.655.20	lekë kualifikuar
12- BOE “Ouen” SHPK & “Shpresa AI” SHPK	31.149.552	lekë kualifikuar
13- BOE “Murati” SHPK & “Klejgi Duri” SHPK	31.590.407	lekë kualifikuar
14- “Shëndëlli” SHPK	32.036.970	lekë kualifikuar
15- “Ndregjoni” SHPK	32.166.393	lekë kualifikuar
16- “Xhast” SHPK	32.201.904	lekë kualifikuar
17- “Bami Holding” SHPK	32.916.502.50	lekë kualifikuar
18- “Varaku E” SHPK	39.856.530	lekë kualifikuar
19- “K. Turja” SHPK	39.874.475	lekë kualifikuar

II.12. Në datën 12.02.2026 BOE “Asi Invest” SHPK & “Company Riviera 2008” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur fizikisht nga BOE “ASI INVEST” shpk & COMPANY RIVIERA 2008 shpk, përkatesisht “ASI INVEST” shpk me nr.Nipt M01927023H me adresë: Rruga Xhorxhi Martini Pallati 17 AP 5 Hyrja 5 Tirane, me administrator Sh. D dhe COMPANY RIVIERA 2008 shpk me nr.Nipt K81716011V, me adresë Kamëz, Rruga

Nacionale Kamëz-Fushë Kruje, Kthesa e Valiasit Nr.1; 1030 me administrator Z.A. K u konstatua se nuk ka arritur të paraqesë dokumentacionin e plotë dhe të sakte për të dëshmuar plotësimin e kriterëve të vecanta për kualifikim sipas dokumentave standarte të tenderit më konkretisht:

1. Nuk ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e plotë sipas pikës 8c Kriteret e Vecanta të Kualifikimit (Kapaciteti teknik) të DST.

8. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Nr Lloji i Makinerive Statusi Sasia

1 Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes jo me pak se 12 Ton Në pronësi ose me qera Copë 1

2 Rul (kopmpresor me vibrim) Në pronësi ose me qera Copë 1

3 Eskavator 0.25m3 Në pronësi ose me qera Copë 1

4 Kamioncine me kapacitet mbajtës deri ne 3.5 ton Në pronësi ose me qera Copë 1

5 Eskavator me çekiç Në pronësi ose me qera Copë 1

6 Betoniere 500 liter Në pronësi ose me qera Copë 1

7 Autobot Në pronësi ose me qera Copë 1

8 Sperkates boje per vijezime ne rruge Në pronësi ose me qera Copë 1

9 Autobitumatriçe Në pronësi ose me qera Copë 1

10 Asfaltoshtruese Në pronësi ose me qera Copë 1

11 Grejder Në pronësi ose me qera Copë 1

12 Vibrator thellesie Në pronësi ose me qera Copë 1

a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) certifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

b) Për mjetet e deklaruar me qira duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse e qirasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit per te trete dhe me qira (e vlefshme).

c) Mjeti autobitumatriçe nder te tjera te shoqerohet edhe me Leje te Transportit te Mallrave te rezikshme (te vlefshme), leshuar nga organet kompetente ne emer te shoqerise apo subjektit pronar te mjetit, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Nga verifikimi i dokumentacionit fizik të paraqitur nga “BOE “ASI INVEST” shpk & COMPANY RIVIERA 2008 shpk u konstatua se:

- Për mjetin Autobitumatriçe me targë TR9831M të deklaruar me qira nga “COMPANY RIVIERA 2008” shpk pjesë e bashkimit, mungon certifikata për transport mallrash brenda vendit për të tretë dhe me qira (e vlefshme), në kundërshtim me pikën 8/b të kapaciteteve teknike.

- Në nenin 41 të Ligjit Nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për Transportet Rrugore”, i ndryshuar, parashikohet se: Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se oferta nuk përmban të gjithë dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e tenderit, referuar listës së kërkesave të tenderit, në mbështetje të

nenit 82 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “ Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me Nenin 77, 87,92 të Ligjit 162/2020, “Për Prokurimin publik”i ndryshuar si dhe Dokumentave Standarde të Tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e operatorit ekonomik BOE “ASI INVEST” shpk & COMPANY RIVIERA 2008 shpk, nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar si ofertë të pavlefshme.

II.13. Referuar sistemit të prokurimeve elektronike si dhe informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se më datë 18.02.2026 operatori ekonomik i kualifikuar i pari “Rej” SHPK i është kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor dorëzimi i dokumentacionit sipas parashikimeve ligjore.

II.14. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se në datën 18.02.2026 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1- “Nika” SHPK	27.389.670	lekë skualifikuar
2- “L.T.E Construction” SHPK	28.033.664.40	lekë skualifikuar
3- BOE “Asi Invest” SHPK & “Company Riviera 2008” SHPK	28.189.581	lekë skualifikuar
4- “Rej” SHPK	28.708.974	lekë kualifikuar
5- “Vëllezërit Hysa” SHPK	29.212.061	lekë kualifikuar
6- “Ndërtimi” SHPK	29.321.856.9	lekë kualifikuar
7- “K.M.K” SHPK	29.916.999	lekë kualifikuar
8- “Drini 1” SHPK	30.109.380	lekë kualifikuar
9- “Caushi M” SHPK	30.718.905	lekë kualifikuar
10- “Bonus” SHPK	30.845.451	lekë kualifikuar
11- “Rruga Ura Asfaltim Nr. 2 Elbasan” SHPK	31.041.655.20	lekë kualifikuar
12- BOE “Ouen” SHPK & “Shpresa Al” SHPK	31.149.552	lekë kualifikuar
13- BOE “Murati” SHPK & “Klejgi Duri” SHPK	31.590.407	lekë kualifikuar
14- “Shëndëlli” SHPK	32.036.970	lekë kualifikuar
15- “Ndregjoni” SHPK	32.166.393	lekë kualifikuar
16- “Xhast” SHPK	32.201.904	lekë kualifikuar
17- “Bami Holding” SHPK	32.916.502.50	lekë kualifikuar
18- “Varaku E” SHPK	39.856.530	lekë kualifikuar
19- “K. Turja” SHPK	39.874.475	lekë kualifikuar

II.15. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton së më datë 26.02.2026 është Publikuar Njoftim Fituesi Paraprak i procedurës së prokurimit objekt- ankimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga ana e autoritetit kontraktor.

II.16. Në datën 03.03.2026, nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. A/2026/6382 dhe me nr. 684/2026 prot, datë 03.03.2026, e operatorit ekonomik “L.T.E Construction” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-71241-12-05-2025, me objekt “Sistemim dhe Asfaltim i Rugës së Fshatit Rashtan, Faza e Dytë, Bashkia Prrenjas” me fond limit: 42,135,943.04 (dyzet e dy milion e njëqind e tridhjetë e pesë mijë e nëntëqind e dyzet e tre pikë zero katër) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 29.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Prrenjas. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “L.T.E Construction” SHPK me pretendimet si vijon:

Pasi u njohëm me vendimin e Komisionit të vlerësimit të Ofertave për s’kualifikimin e ofertës sone, vlerësojmë se, ky vlerësim është bërë në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, e konkretisht:

Ne kete procedure prokurimi komisioni i vleresimit te ofertave ka vepruar ne kundërshtim te plote me neni 2 Qellimi i ligjit te ligjit nr. 162/2021 Per prokurimin publik parashikohet se: Qellim i ketij ligji eshte:

- a) te rrise eficiencyn dhe efikasitetin ne procedurat e prokurimit publik;*
- b) te siguroje mireperdorim te fondeve publike dhe te ule shpenzimet procedurale;*
- c) te nxise pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne procedurat e prokurimit publik;*
- ç) te nxise konkurrencen ndermjet operatoreve ekonomike;*
- d) te siguroje nje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithe operoret ekonomike, pjesemarres ne procedurat e prokurimit publik;*
- dh) te siguroje integritet, besim publik dhe transparence ne procedurat e prokurimit publik.*

Ne neni 3 Parime te pergjithshme te ligjit nr. 162/2021 Per prokurimin publik parashikohet se

- 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojne trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per operoret ekonomike, si dhe veprojne me transparence e ne menyre proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet te shmangin fushen e zbatimit te ketij ligji ose te ngushtojne ne menyre artificiale konkurrencen. Konkurrenca konsiderohet se eshte ngushtuar artificialisht kur prokurimi pergatitet me qellimin per te favorizuar ose demtuar ne menyre te padrejte operoret ekonomike te caktuar.*

Autoriteti Kontraktor ka vepruar ne paligjshmeri dhe ne Shkelje te Ligjit per Prokurimin Publik dhe VKM per Rregullat e Prokurimit Publik. Po japim Argumentat tona per shkeljet e AK si me poshte vijon: Ne piken 5 te DST eshte kerkuar : 5. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik per kryerjen e punimeve, te vertetuar me kontratë punë te vlefshme, një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë) nga organe kompetente si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë për muajin e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, si më poshtë:

- 1 (një) manovratore/automakinist*
- 2 (dy) manovratore/ekskavatorist*

-2 (dy) punonjës shofer

-4 (katër) Specialist betonimi

-10(dhjetë) punonjës të thjeshtë ndërtimi

5.1 Për punonjesit manovrator/shofer/ekskavatorist, ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratën individuale të punës të vlefshme;

- leje drejtimi sipas kategorise perkatese, certifikate e aftesise profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR.

Në rastin kur punonjësit Ekskavatoriste/Automakinist /shofer janë të kontraktuar me kontratë pune, respektivisht për mjetet e marra me qira, nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

Per permushjen e pikes -1 (një) manovratore/automakinist kemi deklaruar ne shtojcen 8 punonjesit si vijon:

Endrit Sulozeqi, me profesion Manovrator, Automakinist i Pajisur me Deshmi Aftesimi Profesional. Me nr DM - 003080, me afat vlefshmerie date 01.07.2029. I pajisur me kontrate pune.

Leonard Rozi me profesion Manovrator, Automakinist i Pajisur me Deshmi Aftesimi Profesional. Me nr DM - 003100, me afat vlefshmerie date 04.07.2029. I pajisur me kontrate pune.

Dhe kemi dorezuar fizikisht prane autoritetit kontraktor me date 26.01.2026 per punonjesit: Endrit Sulozeqi, Deshmi Aftesimi Profesional per Automakinist Me nr DM - 003080, me afat vlefshmerie date 01.07.2029, kontraten e punes dhe Deshmine e kualifikimit te sigurimit teknik. Leonard Rozi Deshmi Aftesimi Profesional per Automakinist Me nr DM - 003100, me afat vlefshmerie date 04.07.2029. kontraten e punes dhe Deshmine e kualifikimit te sigurimit teknik. Bashkengjitur kesaj ankese eshte edhe dokumentacioni i sipermendur.

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për tu përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për tu përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është

ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 Për prokurimin publik , të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

Te dy Automakinistet e mesiperm janë të pajisur me Dëshmi Aftësimi Profesional per Automakinist ne perputhje me Urdhërin Nr. 200, datë 16.5.2019 Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit, Neni 8 c) - Automjete për përdorim të veçantë (APV) sipas pikës g , të nenit 54, të Kodit Rrugor, makineri ndërtimi mbi bazë automjeti: - autovinça, autobetonierë, autopompa betoni, autobitumatriçe, autosonda, autotokmak manovratorëve u jepet dëshmi për Automakinist.

Refuzimi i ofertes sone eshte ne kundershtim me nenin 92 te LPP 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Refuzimi i ofertes sone eshte ne kundershtim me DST e Tenderit Ne Shtojcen 7, Pika 5 e ku eshte kerkuar: Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik per kryerjen e punimeve, te vertetuar me kontratë punë te vlefshme, një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/ certifikatë/diplomë) nga organe kompetente si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë për muajin e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, si më poshtë:

- 1 (një) manovratore/automakinist
- 2 (dy) manovratore/ekskavatorist
- 2 (dy) punonjës shofer
- 4 (katër) Specialist betonimi
- 10(dhjetë) punonjës të thjeshtë ndërtimi

5.1 Për punonjesit manovrator/shofer/ekskavatorist, ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratën individuale të punës te vlefshme;
- leje drejtimi sipas kategorise perkatese, certifikate e aftësisë profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR.

Në rastin kur punonjësit Ekskavatoriste/Automakinist /shofer janë të kontraktuar me kontratë pune, respektivisht për mjetet e marra me qira, nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

Per Punonjesin Automakinist eshte kerkuar ne piken 5 te kete kontratë punë te vlefshme, një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/

certifikatë/diplomë) nga organe kompetente si dhe te figurojnë ne listpagesat e shoqërisë për muajin e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, ndersa ne piken 5.1 eshte kerkuar Për punonjesit manovrator/shofer/ekskavatorist, ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratën individuale të punës te vlefshme;

- leje drejtimi sipas kategorise perkatese, certificate e aftesise profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR.

Pra ne asnje rast per punonjesit Automakinist nuk eshte kerkuar dokumentacion tjetër nga Autoriteti Kontraktor, pervec kontratë punë te vlefshme, një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/ certifikatë/diplomë).

Pra nga sa më sipër si dhe referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për tu përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në përgjigje të kësaj ne si operator ekonomik kemi përgatitur ofertën, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe atë që parashikon ligji për rastin konkret.

Kete arsyetim tendencioz dhe te pambështetur të autoritetit kontraktor e gjejme të pa argumentuar, ndaj vendimi i KVO nuk qendron.

Si përfundim përsa parashtruar më sipër kërkojmë që të rrëzohet arsyeja e skualifikimit e dhënë nga autoriteti kontraktor si e pa bazuar dhe argumentuar, dhe kualifikimin e ofertës sonë si ofertë që i plotëson kriteret kualifikuese të hartuara nga autoriteti kontraktor në DST.

II.17. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 684/1 prot., datë 04.03.2026 janë publikuar arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “L.T.E Construction” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 684/2026 prot, datë 03.03.2026.

II.18. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se më datë 06.03.2026 pranë Komisionit Prokurimit Publik nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike është protokolluar

me nr. 684/2 prot, datë 06.03.2026 Formulari i paraqitjes së argumentave nga subjekti interesuar “Rej” SHPK, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

II.19. Më datë 09.03.2026 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike autoriteti kontraktor ka dërguar shkresën me objekt “Dërgim Vendimi” protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me nr. 684/3 prot, datë 09.03.2026 bashkalidhur të cilit është dhe akti trajtimit të ankesës nr. 23 datë 06.03.2026 i operatorit ekonomik ankimues, nga verifikimi i të cilit rezulton se autoriteti kontraktor ka vendosur refuzimin e ankesës.

II.20. Me qëllim shqyrtimin e ankesën e operatorit ekonomik ankimues, me anë të shkresës nr. 684/4 prot., datë 11.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar autoritetit kontraktor që të dërgojë pranë KPP-së dokumentacionin e dorëzuar pranë autoriteti kontraktor nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, në lidhje me vërtetueshmërinë e deklarimeve në shtojcën 8 Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, sikurse përcaktohet në pikën 1 dhe 6 të nenit 26 të VKM 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar.

II.21. Me shkresën nr. 765/1 prot, datë 13.03.2026, me objekt “Dërgim dokumentacioni”, protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 684/5 prot., datë 17.03.2026 autoriteti kontraktor Bashkia Prrenjas ka dërguar informacion dhe dokumentacion në zbatim të shkresës nr. 684/4 prot., datë 11.03.2026, të Komisionit Prokurimit Publik.

II.22. Me shkresën nr. 765/2 prot, datë 30.03.2026, me objekt “Kërkesë për shpejtim vendimi”, protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me nr. 684/6 prot, datë 31.03.2026, Bashkia Përrenjas kërkon përshpjegimin e vendimarrjes për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “L.T.E Construction” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen se: “Pas mbylljes së fazës së vlerësimit të ofertave komisioni vendosi ti dërgojë në datë 22.01.2026 njoftim për paraqitje dokumentacioni fizik operatorit të renditur i pari L.T.E Construction shpk. Dokumentacioni u paraqit nga OE L.T.E Construction shpk në datë 26.01.2026. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur fizikisht nga OE “L.T.E Construction” shpk me nipt L78006801F me adresë: Rruga 3 Deshmoret, Kompleksi Grand, Ap F-2-08 kati 1, Kashar, Tirane 1001, me administrator Artur Caushaj, u konstatua se nuk ka arritur të paraqesë dokumentacionin e plote dhe të sakte për të dëshmuar plotësimin e kriterëve

të vecanta për kualifikim sipas dokumentave standarte të tenderit më konkretisht: 1. Nuk ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e plotë sipas pikës 5 dhe 5.1 Kriteret e Vecanta të Kualifikimit (Kapaciteti teknik) të DST. 5. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/ certifikatë/diplomë) nga organe kompetente si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë: -1(një) manovrator/automakinist; -2 (dy) manovrator/ekskavatorist; -2 (dy) punonjës shofer; -4 (katër) Specialist betonimi; -10 (dhjetë) punonjës të thjeshtë ndërtimi. 5.1 Për punonjesit manovrator/shofer/ekskavatorist, ofertuesi duhet të paraqesë: - kontratën individuale të punës të vlefshme; -leje drejtimi sipas kategorise perkatese, certifikate e aftesise profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR. Në rastin kur punonjësit Ekskavatoriste/Automakinist /shofer janë të kontraktuar me kontratë pune, respektivisht për mjetet e marra me qira, nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë). Nga verifikimi i dokumentacionit fizik të paraqitur nga operatori ekonomik “L.T.E Construction” shpk rezultuan këto mangësi: Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit janë deklaruar si Automakinistë punonjësit Endrit Sulozeqi dhe Leonard Rozi. Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se për këta punonjës mungon leja e drejtimit të mjetit, në kundërshtim me nenin 115 të Ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i cili përcakton se drejtimi i mjeteve motorike mbi 3.500 kg kërkon leje drejtimi të vlefshme. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se oferta nuk përmban të gjithë dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e tenderit, referuar listës së kërkesave të tenderit, në mbështetje të nenit 82 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar. Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me Nenin 77, 87,92 të Ligjit 162/2020, “Për Prokurimin publik”i ndryshuar si dhe Dokumentave Standarde të Tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e operatorit ekonomik “L.T.E Construction” shpk nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar si ofertë të pavlefshme”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.5 “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

5. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/ certifikatë/diplomë) nga organe kompetente si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

- 1 (një) manovrator/automakinist.
- 2 (dy) manovrator/ekskavatorist.
- 2 (dy) punonjës shofer.
- 4 (katër) Specialist betonimi.
- 10 (dhjetë) punonjës të thjeshtë ndërtimi.

5.1 Për punonjesit manovrator/shofer/ekskavatorist, ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratën individuale të punës te vlefshme;
- leje drejtimi sipas kategorise perkatese, certificate e aftesise profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR.

Në rastin kur punonjësit Ekskavatoriste/Automakinist/shofer janë të kontraktuar me kontratë pune, respektivisht për mjetet e marra me qira, nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

5.2 Shënim. Për puntorët e thjeshtë, duhet të disponojne kontratë punë te vlefshme, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet perkatese vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

III.1.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm të kualifikimit referuar sistemit të prokurimeve elektronike si dhe shkresës me nr. 765/1 prot., datë 13.03.2026, protokolluar pranë KPP-së me nr. 684/5 prot., datë 17.03.2026 rezulton se operatori ekonomik “*L.T.E Construction*” SHPK ndër të tjera ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “*L.T.E Construction*” SHPK të nënshkruar dhe vulosur, ku në pjesën III Kriteret e Përzgjedhjes kualifikimit, pika B Deklaratë “*Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate*”, ndër të tjera evidentohet se ka deklaruar E. S automakinist, L. R automakinist.
- Kontratë Pune datë 02.03.2021 lidhur ndërmjetë punëdhënësit “*L.T.E Construction*” SHPK dhe punëmarrësit L. R.
- Dokumentin “Dëshmi Aftësie Profesionale” për automakinist në emër të z. L. R.
- Kontratë Pune datë 02.03.2021 lidhur ndërmjetë punëdhënësit “*L.T.E Construction*” SHPK dhe punëmarrësit E. S.
- Dokumentin “Dëshmi Aftësie Profesionale” për automakinist në emër të z. E. S;

III.1.3. Në nenin 2 “*Qëllimi i ligjit*” të ligjit nr. 162/2021 “*Për prokurimin publik*” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efijencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.1.4. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.1.5. Në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të

njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

III.1.6. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së, i ndryshuar, përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.*

III.1.7. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

- c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;
- dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;
- e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;
- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.
3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.
4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.
5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.
6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime”.

III.1.8. Në nenin 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet se:

“6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”

III.1.9. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje

me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai i barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.1.10. Konkretisht, referuar kriterit në pikën 2.3.5 për disponimin e punonjësve që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, konstatohet se autoriteti kontraktor ndër të tjera ka kërkuar që operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vërtetuar me kontratë punë të vlefshme, një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë) nga organe kompetente si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë: - **1 (një) manovratore / automakinist; - 2 (dy) manovratore / ekskavatorist; - 2 (dy) punonjës shofer; - 4 (katër) specialist betonimi; - 10 (dhjetë) punonjës të thjeshtë ndërtimi. Për punonjesit manovrator / shofer / ekskavatorist, ofertuesi duhet të paraqesë: - kontratën individuale të punës te vlefshme; - leje drejtimi sipas kategorise perkatese, certificate e aftesise profesionale / Patente Manovrimi nga DPSHTRR. Në rastin kur punonjësit Ekskavatoriste/Automakinist /shofer janë të kontraktuar me kontratë pune, respektivisht për mjetet e marra me qira, nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë). Shënim. Për puntorët e thjeshtë, duhet të disponojnë kontratë punë te vlefshme, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet perkatese vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).** Nga verifikimi në SPE vihet re, se në përmbushje të kriterit më sipër operatori ekonomik “L.T.E Construction” SHPK ka dorëzuar formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të cilin në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi, autoriteti/enti kontraktor e pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontraktor të kryejë verifikime në rast nevojë apo të dërgojë kërkesa për sqarim mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë. Nisur nga arsyeja e skualifikimit, me arsyetimin se: [.....] Nga verifikimi i

dokumentacionit fizik të paraqitur nga operatori ekonomik “L.T.E CONSTRUCTION” shpk rezultuan këto mangesi: Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit janë deklaruar si Automakinistë punonjësit E. S dhe L. R. Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se për këta punonjës mungon leja e drejtimit të mjetit [.....]. Komisioni i Prokurimit Publik nga verifikimi në SPE konstaton se operatori ekonomik “L.T.E Construction” SHPK ka dorëzuar Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të firmosur dhe vulosur, ku në pjesën e III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit B: Deklaratë “Për e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, ndër të tjera ka deklaruar punonjësit e kërkuar nga autoriteti kontraktor për realizimin e kontratës, ndër të tjera edhe punonjësit e kërkuar në kriterin 2.3.5 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit. Duke qenë se operatori ekonomik “L.T.E Construction” SHPK është kualifikuar në procedurën e prokurimit, KPP në kuadër të shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “L.T.E Construction” SHPK, me anë të shkresës nr. 684/4 prot., datë 11.03.2026, i kërkoi autoriteti kontraktor, në mbështetje të nenit 82 pika 5 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 26 të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, të dorëzojë pranë KPP-së dokumentacionin e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, nga operatori ekonomik “L.T.E Construction” SHPK, si operator ekonomik i kualifikuar në procedurën e prokuimit objekt ankimi. Nëpërmjet shkresës me nr. 765/1 prot., datë 13.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 684/5 prot., datë 17.03.2026 me objekt “Dërgim informacioni”, është depozituar nga autoriteti kontraktor dokumentacioni i dorëzuar fizikisht pranë këtij të fundit, nga operatori ekonomik “L.T.E Construction” SHPK.

III.1.11. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, dokumentet e tenderit, si dhe informacioni dhe dokumentacioni i dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstaton se operatori ekonomik “L.T.E Construction” SHPK, si operator ekonomik i kualifikuar në këtë procedurë prokurimi, në zbatim të nenit 26 pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni, konstatohet se operatori ekonomik “L.T.E Construction”, shpk ka dorëzuar Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të nënshkruar dhe vulosur, si dhe ndër të tjera ka dorëzuar edhe dokumentacionin për përmbushjen e pikës 2.3.5 dëshmite e aftësie profesionale (të vlefshme), përkatëse sipas modaliteteve të urdhrit Nr. 200, datë 16.5.2019. 1- Kontratë Pune datë 12.04.2021 lidhur midis “L.T.E Construction” SHPK dhe punonjësit E. S në rolin e automakinistit; 2- Dokumentin “Dëshmi Aftësie Profesionale” për automakinist në emër të z. E. S; 3- Kontratë Pune datë 02.03.2021 lidhur midis “L.T.E Construction” SHPK dhe punonjësit L. R në rolin e automakinistit 4- Dokumentin “Dëshmi Aftësie Profesionale” për automakinist në emër të z. L. R. Duke marrë shkasë nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, si dhe referuar kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.5 të DST, në të cilin autoritetit kontraktor ka kërkuar që **5.1 Për punonjësit manovrator/shofer/ekskavatorist, ofertuesi duhet të paraqesë: - kontratën individuale të punës të vlefshme; - leje drejtimi sipas kategorise perkatese, certifikate e aftësie profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR.**

Komisioni pasi verifikoi dokumentacionin e dorëzuar fizikisht pranë autoritetit kontraktor nga operatori ekonomik ankimues, përcjellë pranë KPP me shkresën nr. 765/1 prot., datë 13.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 684/5 prot., datë 17.03.2026, nga operatori rezulton se operatori ekonomik ankimues ka paraqitur në përmbushje të kriterit të sipërpërmendur 2.3.5, 1- Kontratë Pune datë 12.04.2021 lidhur midis “L.T.E Construction” SHPK dhe punonjësit E. S në rolin e automakinistit; 2- Dokumentin “Dëshmi Aftësie Profesionale” për automakinist në emër të z. E. S; 3- Kontratë Pune datë 02.03.2021 lidhur midis “L.T.E Construction” SHPK dhe punonjësit L. R në rolin e automakinistit 4- Dokumentin “Dëshmi Aftësie Profesionale” për automakinist në emër të z. L. R. Nga ky verifikim nuk rezulton të jenë dorëzuar leja drejtimi për punonjës in manovrator automakinist sikurse është kërkuar në pikën 5.1 të kriterit 2.3.5, ku përveç **certifikatës së aftësisë profesionale/Patente Manovrimi** është kërkuar edhe **leje drejtimi sipas kategorisë perkatese**. KPP gjykon, se operatori ekonomik ankimues pas kualifikimit në vend të parë, ka dështuar të provojë se ka dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, pra nuk është paraqitur asnjë dokument për të provuar se këta punonjës janë të pajisur me **leje drejtimi sipas kategorisë perkatese**. KPP sqaron, se subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor, e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme. Operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në rastin konkret ndodhemi në kuptimin klasik të barrës së provës referuar parimit juridik *onus probandi incumbit actor (barra e provës i bie kërkuesit)*, si edhe në përputhje me nenin 82 pika 1 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në të cilin parashikohet se: “*në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj*”. Ndërkohë nga ana e autoritetit kontraktor rezulton e provuar, se dokumentacioni është dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues pranë tij, në të cilin konstatohet se është dorëzuar, “1- Kontratë Pune datë 12.04.2021 lidhur midis “L.T.E Construction” SHPK dhe punonjësit E. S në rolin e automakinistit; 2- Dokumentin “Dëshmi Aftësie Profesionale” për automakinist në emër të z. E. S; 3- Kontratë Pune datë 02.03.2021 lidhur midis “L.T.E Construction” SHPK dhe punonjësit L. R në rolin e automakinistit 4- Dokumentin “Dëshmi Aftësie Profesionale” për automakinist në emër të z. L. R”, dhe nuk është paraqitur asnjë dokument (**leje drejtimi sipas kategorisë perkatese**) për të provuar se këto punonjës (manovrator automakinist) janë të pajisur me leje drejtimi sipas kategorisë perkatese. Referuar të gjithë arsyetimit më lart KPP gjykon, se operatori ekonomik ankimues pas kualifikimit si i pari, ka dështuar të provojë se ka dorëzuar pranë autoritetit kontraktor për punonjës in manovrator automakinist **leje drejtimi sipas kategorisë perkatese**. Si përfundim, nga analiza e fakteve të spërcituara, Komisioni gjykon se, operatori ekonomik

ankimues me dokumentacionin e paraqitur nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.5 të dokumentave të tenderit.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “*L.T.E Construction*” SHPK nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “*L.T.E Construction*” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*” me Nr. REF-71241-12-05-2025, me objekt “*Sistemim dhe Asfaltim i Rugës së Fshatit Rashtan, Faza e Dytë, Bashkia Prrenjas*” me fond limit: 42,135,943.04 (dyzet e dy milion e njëqind e tridhjetë e pesë mijë e nëntëqind e dyzet e tre pikë zero katër) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 29.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Prrenjas.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së mësipërme të prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë derdhjen në buxhetin e shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*L.T.E Construction*” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

